nga Gent Mebelli
E shtunë, 06 Shkurt 2021 00:00

## Elvis Rexhbecaj rock and roll ne derbin e Rinit




Rruga që familja Rexhbecaj bëri nga fshati i vogël malor Gjonaj për në Gjermani në vitin 1999 ishte e pazakontë, Elvisi së bashku

me vëllain e tij Blendard, motren, nënën shtatzene dhe babanë largohen nga terrori serb ne Kosovës drejt Berlinit,

**NE KEMBE !!!**

"Babai im më çoi në Gjermani duke me mbajtur ne krahe." Tregon Elvis Rexhbecaj qe përshkruan fëmijërinë e tij ne Brandenburg si të lumtur.

Me prinder qe bene cfare munden te plotesonin deshirat e femijeve. Ndërkohë është 23-vjeçari ai që i kthen sot familjes shume lumturi

dhe ben krenar cdo shqiptar qe jeton ne Gjermani.

Karriera ne Bundeslige fillon me tranierin Bruno Labbadia i cili e aktivizon rregullisht te klubi i Vfl Wolfburg.

Por pasardhësi Oliver Glasner nuk i mbështetet planet e tija te Elvisi i talentuar. Ai huazohet në Këln ku prej një viti luan rregullisht

deri sa vjen mrekullia: "You are in history." I therrisnin shoket e skuadres ndersa kendonin duke u kthyer fitimtare

**ne AUTOBUSIN e 1FC KÖLN!!!**

U deshen te kalonin tre vjet qe Kölni te fitonte Derbin e Rinit kunder Borussia Mönchengladbach me dy golat e Elvis Rexhbecaj qe siguroi një vend të përhershëm në zemrat

e tifozëve të klubit me shume tradite ne Bundeslige.

Si dhe ku do të vazhdojë karriera e Elvis Rexhbecaj përtej verës është ende e paqartë. Huazimi i tij do të përfundojë pas sezonit dhe në Wolfsburg me siguri do ta kene parë

se si Elvisi kendoi ne Derbin e zjarrte.

Gent Mebelli